

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione te pergjitheshme

"REGLI" sh.p.k., eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 26/09/2004. Kapitali rregjistruar eshte 13 100 000 dhe zotrohet 100% nga ortakut themelues, z. Nj. PRENCI, njekohesisht dhe perfaqesues ligjor i saj. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2019 eshte aktiviteti ne ndertim.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2019 eshte zbatuar formati i SKK-15 i pemiuresuar.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj riveleshohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk riveleshohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2019 janë 1 EUR=121,77 leke dhe 1 USD= 108,64 leke.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin është 15 %.



Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e vlerës së mbetur. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndertesat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Norma e përdorur e amortizimit për të gjitha Aktivet Afatgjata materiale për vitin ushtrimor është 20 %.

Gjendjet e inventarit

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

1. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në bankë dhe arke, në lekë dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja në 31.12.2018		Gjendja në 31.12.2017	
		Në lekë	Në valute	Në lekë	Në valute
Llogari bankare	LEK	1,450,830	-11,040	14,226,545	-11,040
Arka në lekë	LEK	746,360		754,934	-
Shuma		2,197,190	-11,040	14,981,479	-11,040

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin zyrtar të këmbimit në fundit të ushtrimit.

2. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kërkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme (klient)	30,870,054	44,241,030
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme (Tatim fitimi)	1,066,247	921,847
(iii) Te kreditueshme nga shteti (Tvsh)	86,990	59,697
(iv) Kërkesa të tjera të arkëtueshme (doganore)	6,464	6,464
(v) Debitore të tjera	5,000,000	
Shuma	37,029,755	45,229,038

Në "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar faturat e palikuiduara të klienteve të ndryshëm kryesisht Institucione Publike me të cilët shoqëria ka marrëdhënie financiare.



"REGLI" SHPK – shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare 2019

Ne zerin " Kerkesa te tjera te arketueshme/Tatim fitimi" eshte pasqyruar teprica e tatim fitimit ne fund te vitit e korrektuar nga Rezultati ne fund te vitit minus parapagimet gjate vitit.

Ne zerin " Kerkesa te tjera te arketueshme " eshte pasqyruar shuma prej 6 464 leke, e arketueshme ndaj doganes per derdhje me teper ne llogarine doganore, dhe ne TVSH eshte paraqitur TVSH per tu marre.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje perudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.Vlera prej 5,000,000 leke eshte teprica e llogarise midis huadhenies e huamarrjes sipas kontratave respektive.

3. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Inventari		
(i) Lëndët e para	-	-
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për shitje	-	-
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
Shuma	-	-

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatiit me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e koston se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".

Shuma e inventarit te paraqitur ne "Mallra per shitje" dhe ne "Lendet e para" perfaqson stokun e mallrave dhe te lendeve te para, te vleresuara me koston e blerjes.

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes koston se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

4. Aktivët Afatgjatë Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjatë materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe pajsje	Aktivët te tjera afatgjatë materiale	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2019	-	-	4,032,879	-	4,032,879
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
Kosto e AAM-ve me 31.12.2019	-	-	4,032,879	-	4,032,879
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2019	-	-	-	-	-
Amortizimi ushtrimit	-	-	620,948	-	620,948
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2019	-	-	620,948	-	620,948
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2019	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2019	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2019	-	-	4,032,879	-	4,032,879
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2019	-	-	3,411,931	-	3,411,931

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e vleres se mbetur(SNK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston



e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi plus shtesat dhe vleresimet qe mund te jene bere gjate vitit .

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane jo me shume se ato qe perdoren per qellime fiskale.

Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale, konkretisht = 20% cdo aktivi.

5. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 nuk ka.

6. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Huatë dhe parapagimet		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	24,360,561	24,345,561
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	8,147,594	11,150,151
(iii) Detyrimet tatimore(TAP)	11,050	11,050
(iv)Te tjera detyrime (Sig shoqerore)	107,109	170,841
(v)Detyrime ndaj shtetit per TVSH		
(viii) Tatim mbi fitimin		
(vi) Tatime per tu sistemuar (Tvsh)	1,186,082	1,186,082
(vii)Kreditore te tjere - Dividente per tu paguar	1,481,926	9,616,585
Shuma	35,294,322	46,480,270

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likuiduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.Drejtimi mendon se te drejtat e furnitorëve jane te vleresuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit .

"Detyrimet tatimore per sig.shoqerore" , TAP ,TVSH, Tatim qera, jane te muajit Dhjetor qe paguhen ne muajin pasardhes. Tatim fitimi eshte detyrimi per tu paguar sipas korrektimit te rezultatit me kestet e parapaguara. Vlera 1,481,926 leke eshte detyrimi ndaj Ortakut te vetem z. Njazi Prenci si pasoje e vendimit te asamblese per shperndarje fitimi-divident i papaguar.

7. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Hua afatgjata ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 nuk ka.

8. Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR + shtesen e kapitalit prej 13,000,000 leke te bere gjate vitit 2013 nga fitimet e akumuluar ne vite. Me 31.12.2019, kapitali themeltar eshte 13.100.000 leke, i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 131 000 leke /kuota. Vlera e kapitalit zoterohet 100% nga ortakut i vetem z. Njazi Prenci. Sipas Vendimit te Ortakut per miratimin e Pasqyrave Financiare 2018 Rezervat ligjore jane 1,537,585 leke, fitimi i pashperndare 0 leke dhe fitimi i vitit 2018 eshte shperndare ne formen e dividendit, por nuk eshte paguar ende total, tatimi mbi dividendin eshte paguar



9. Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2018	31
Te ardhurat nga shitja e produkteve			
Te ardhurat nga kryerja e punimeve ne ndertim			43,264,575
Te ardhurat te tjera			
Shuma	0	43,264,575	

Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme të zhveshura nga TVSH-ja . Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve është bere sipas natyres se tyre.

Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave dhe shërbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksat e tatime te tjera qe lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar ne llogaritë e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit janë treguar ne pasqyren perkatese.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Materialet e konsumuara		(27,581,703)
Kosto e punes	(6,132,106)	(9,469,441)
1-Paga personeli	(5,197,167)	(8,065,888)
2-Sigurime shoqerore dhe shëndetsore	(934,939)	(1,403,553)
3-Te tjera personeli		
Amortizime dhe zhvleresime	(620,948)	(1,008,220)
Shpenzime te tjera	(536,274)	(1,497,301)
Shuma	(7,289,328)	(39,556,665)

KMSH per vitin 2019 është = 0 leke . Shpenzimet e amortizimit per vitin ushtrimor janë 620,948 leke.

Ne zerin "Shpenzime te tjera " bejne pjese : shpenzime kancelarie dhe te ngjashme 0 leke, shpenzime qeraje 120,000 leke, mirembajtje dhe riparime 3,325 leke, sigurime kontrate dhe oferte janë 0 leke, kosto e auditimit te bilancit është 0 leke, shpenzime telefoni dhe interneti 134,041 leke, taxa dhe tarifa vendore 278,907 leke,

▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)		
Shpenzimet per interesat 767, 668(-)		
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)		
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)		
Të ardhura dhe shpenzime te tjera financiare 768, 668		
Te ardhura dhe shpenzime financiare (shërbime bank)	(14,743)	(28,416)
Shuma	(14,743)	(28,416)

Shoqeria ka shpenzuar 14,743 leke shërbime te ndryshme bankare sipas konfirmes bankare.



"REGLI" SHPK – shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare 2019

Fitimi I ushtrimit dhe tatimi mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2019 dhe 2018 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	(7,304,071)	3,679,493
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	-	87,121
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime prirje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoha, penalitete, demshperblime	-	87,121
4 Provizione qe nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera	-	-
III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE (I+II-III)	(7,304,071)	3,766,614
V Shpenzimi i tatim fitimit-15%		564,992
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT (I-V)	(7,304,071)	3,114,501

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem i cili ka dale pasi i jane shtuar fitimit te ushtrimit edhe shpenzimet e pazbriteshme.

10. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

11. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2019 jane te krahasueshme me ato te pasqyrave te ushtrimit 2018 te ndertuara sipas SKK-ve.

HARTUESI I BILANCIT

Hysen Zyberaj

ADMINISTRATORI

Njazi PRENCI

